

LIGJI PER QEVERINE E REPUBLIKES SE MAQEDONISE

("Gazeta zyrtare e Republikes se Maqedonise" nr.59/2000, 12/23, 55/05, 37/06, 115/07, 19/08, 82/08, 10/10, 51/11, 15/13, 139/14, 196/15, 142/16, 140/18 dhe "Gazeta zyrtare e Republikes se Maqedonise se Veriut" nr.98/19)

I. DISPOZITA THEMELORE

Neni 1

Me kete ligj rregullohet organizimi, menyra e punes dhe kompetencat e Qeverise se Republikes se Maqedonise.

Neni 2

Qeveria e Republikes se Maqedonise (ne tekstin e meposhtem: Qeveria), si bartes i qeverisjes ekzekutive eshte organ i Republikes se Maqedonise e cila pune nen kompetencat e saj i kryen ne menyre te pavarur, ne kornizat e Kushtetutes, ligjeve dhe marreveshjeve nderkombetare te ratifikuara, por ne baze te principeve te transparences, efikasitetit dhe mbrojtjes se lirive dhe te drejtave te njeriut.

Neni 3

- (1) Qeverine e zgjedh dhe shkarkon Kuvendi i Republikes se Maqedonise se Veriut (ne tekstin e meposhtem: Kuvendi) me shumice te votave nga numri i pergjithshem i deputeteve
- (2) Pergjat propozimit te perberjes se Qeverise, mandatar i propozon ministra per secilen ministri te percaktuara me lid dhe ministrite pa resor.
- (3) Qeveria e merr detyren ne ditene e zgjedhjes se saj.

Neni 4

- (1) Ne kornizat e te drejtave dhe detyrimeve te percaktuara me Kushtetute dhe me ligj, Qeveria e percakton politiken ekonomike dhe zhvillimore te shtetit, percakton masa per realizimin e tyre dhe i propozon masa Kuvendit per realizimin e politikave te cilat jane ne kompetencen e saj, percakton politika per zbatimin e ligjeve dhe akteve tjera te Kuvendit, ndjek zbatimin e tyre dhe kryen detyra tjera te peraktuara me ligj.
- (2) Ne kornizat te drejtave dhe detyrimeve te saj te percaktuara me Kushtetute dhe me ligj, Qeveria dhe cdo anetar i saj, per punen e tyre pergjigjen para Kuvendit.

Neni 5

- (1) Qeveria sjell Rregullore per punen e Qeverise (ne tekstin e meposhtem: Rregullore

(2) Ne pajtim me kete ligj me Rregulloren percaktohen me hollesisht organizimi i brendshem, menyra e punes, si dhe ceshtje tjera me relevance per punen e Qeverise.

Neni 6

Per shkak te ushtrimit te kompetencave te saj, Qeveria sjell programin vjetor per pune.

Neni 7

(1) Qeveria eshte e obliguar te informoje opinionin per punen e saj dhe per realizimin e programit nga neni 6 i ketij ligji.

(2) BQeveria nuk publikon informata te cilat i referohen sigurise kombetare, sekretit publik, si dhe te dhenat personale te qytetareve ne pajtim me ligjin me te cilin rregullohet mbrojtja e te dhenave personale te qytetareve.

(3) PCeshtjet te cilat referohen menyres se informimit te opinionit per punen e Qeverise, percaktohen me Rregulloren.

II. KOMPENTENCAT E QEVERISE

Neni 8

Qeveria, pevec kompetencave me Kushteute, kryen edhe keto detyra si vijon:

- 1) percakton politiken zhvillimore dhe ekonomike;
- 2) percakton programin per aktivitetet ne fushen e mbrojtjes dhe sigurise dhe siguron zbatimin e tyre;
- 3) merr mass per realizimin e tregut te lire dhe sipermaresise, si dhe masa kunder pozites monopolistike dhe qasjes monopolistike ne treg;
- 4) nxit avansimin ekonomik dhe realizimin e zhvillimin te barabarte hapsinor dhe regjionae dhe zhvillim me te shpejte te zonave me pak te zhvilluara;
- 5) percakton strategjiine per terheqjen e investimeve te huaja;
- 6) vendos per disponimin dhe shfrytezimin e kapitalit shteteror ne pajtim me ligjin;
- 7) nxit dhe ndihmon zhvillimin shkencor dhe teknologjik;
- 8) percakton strategjin dhe merr masa per kyeje ne integrimet evropiane dhe euroatlantike dhe ne strukturat tjera nderkombetare;
- 9) ndjek dhe analiyon rrethanat per zbatimin dhe avansimin e te drejtave te njeriut dhe lirive te qytetareve;
- 10) nxit zhvillimin e insitucioneve te shoqerive civile;
- 11) merr masa per krijimin e kushteve per zbatimin e te drejtave te qytetareve per arsimim, mbrojtje shendetesore, sigurim social dhe zhvillimin e resurseve njerezore;
- 12) merr masa per krijimin e kushteve per mbrojtje sociale dhe siguri sociale te qytetareve dhe

13) kryen edhe pune te tjera te percaktuara me ligj.

Neni 9

Qeveria eshte e detyruar ne momentin qe vlereson se nuk respektohen ligjet dhe aktet tjera ose nuk realizohet politika ekonomike dhe zhvillimore e percaktuar dhe masat per realizimin e asaj politike, te ndermer masa per te cilat eshte kompetente, perkatesisht te propozoje Kuvendit per nderrmarjen e masave te duhura.

Neni 10

Ne gjendje lufte dhe gjendje te jashtezakoneshme, nese nuk ekziston munesi per thirrjen e Kuvendit, Qeveria sjell urdheresa me fuqi te ligjit per ceshtje ne kompetence te Kuvendit.

III. TE DRJETA DHE DETYRAT E KRYETARIT DHE ANETAREVE TE QEVERISE

Neni 11

- (1) Kryetari i Qeverise udheheq me punen e Qeverise, eshte pergjegjes per punen e saj dhe bashkepunon me organet te tjera, nedrrmarje dhe drejtori publike.
- (2) Kryetari i Qeverise e drejton veprimtarine e Qeverise ne terresi dhe te anetareve te saj ne pajtim me percaktimet dhe drejtimet programore qe parashihen.
- (3) Kryetari i Qeverise i nenshkruan dispozitat dhe aktet qe i sjell Qeveria dhe kujdeset per realizimin e tyre.
- (4) Kryetari i Qeverise formon Zyre e cila do te ndihmoje ne kryerjen e te drejtave dhe detyrimeve qe dalin nga Kushtetuta, ligji dhe Rregullorja.
- (5) Kryetari i Qeverise mban bashkepunim edhe me shoqeri tegtare, shoqata civile dhe subjekte tjera juridike.

Член 12

- (1) Anetaret e Qeverise kane te drejta dhe detyrim te marrin pjese ne punen Qeverise, te inicoje iniciativa per pergaditjen e ligjeve dhe akteve tjera propozimi i te cilave eshte kompetence Qeverise, te dispozitave dhe akteve tjera te cilat i sjell Qeveria dhe per percaktimin e udhezimeve dhe qendrimeve, inicimin e iniciativave per sjelljen e vendimeve ne kompetence te Qeverise, si dhe te marrin pjese ne te marrin pjese ne kryerjen e kompetencave te Qeverise ne pajtim me konkludimet e Qeverise dhe Rregullores.
- (2) Anetari i Qeverise i cili eshte i caktuar te marre pjese ne organe dhe trupa tjere eshte i detyruar te veproje sipas autorizimeve, udhezimeve dhe qendrimeve te Qeverise.

Neni 13

Ministri ne menyre te pavarur udheheq me ministrine ne te cilen eshte zgjedhur, e ndje dhe eshte pergjegjes per zbatimin e ligjeve dhe akteve tjera.

Neni 14

Kryetari i Qeverise gezon imunitet, si edhe deputetet ne Kuvendin e Republikes se Maqedonise. Per imunitetin e tij vendos Kuvendi.

Neni 14 - a

Kryetari i Qeverise se Republikes se Maqedonise te cilit i eshte nderprere funksioni ka te drejte per sigurim personal prej gjashte personave te punesuar ne njesine organizative per sigurim te personave dhe objekteve ne Ministrine e Puneve te Brendshme, si dhe te drejte per shfrytezim te vetures zyrtare dhe shoferit.

Personat nga paragrafi 1 i ketij neni, zgjidhen nga Kryetari i Qeverise se Republikes se Maqedonise te cilit i eshte nderprere funksioni.

Kryetari i Qeverise se Republikes se Maqedonise te cilit i eshte nderprere funksioni, te drejten nga paragrafi 1 i ketij neni e realizon ne periudhe te njejte me periudhen e kohezgjatjes se kryerjes se funksionit kryetar i Qeverise se Republikes se Maqedonise dhe fillon ta realizoje nga dita e nderprerjes se funksionit.

Kryetari i Qeverise se Republikes se Maqedonise i cili e ka kryer funksionin me pak se nje vit, te drejten nga paragrafi 1 i ketij neni e realizon ne periudhe prej nje viti nga dita e nderprerjes se funksionit

IV. PERFAQESIMI DHE DELEGIMI I AUTORIZIMIT

Neni 15

Kryetari i Qeverise perfaqeson Qeverine.

Neni 16

- (1) Kryetari i Qeverise nga rradhet e ministrave percakton zevendesit.
- (2) Kryetarin e Qeverise e zevendeson zevendesi i tij.
- (3) Kryetari i Qeverise mund te delegoj zevendesit te tij kryerjen e detyrave te caktuara te cilat rrjedhin nga te drejtat dhe detyrimet e tij.

Neni 17

Pas autorizimit te kryetarit te Qeverise, cdo anetar i Qeverise mund ta perfaqesoje ne Kuvend dhe trupat e punes te Kuvendit dhe te perfaqesoje qendrimin e Qeverise.

Neni 18

- (1) Kryetari i Qeverise me propozim te ministrit mund te autorizoj sekretarin shteteror ose udhheqeesin e sektorit te ministrise kompnete te marr pjese ne punen e trupit punues te Kuvendit.
- (2) Nese kryetari i Qeverise nuk pranon propozimin nga paragrafi (1) i ketij neni atehere Qeveria vendos per autorizimin.

V. MENYRA E PUNES SE QEVERISE

Neni 19

- (1) Per detyrat nga kompetencat e saj Qeveria punon dhe vendos nese ne seance marrin pjese me shume se gjysma e anetareve te Qeverise.
- (2) Ne rast te pengeses dhe mungeses se anetarit te Qeverise, ne mbledhjen e Qeverise mund te marre pjese dhe te vendose zevendesministri i cili e zevendeson anetarin e Qeverise me te gjitha te drejtat, detyrat dhe pergjegjesite e tij dhe i njejti llogaritet ne shumicen e te pranishmeve sikur te jete i pranishem anetari te cilen e zevendeson.
- (3) Seancat e rregullata te Qeverise i fton kryetari i Qeverise me vetiniciative ose pas kerkeses te se paku 1/3 e anetareve te Qeverise, ndersa mundet edhe pas kerkeses se ministrave te njerit prej partnereve te koalicionit ne Qeveri.

Neni 20

- (1) Ne seancat e saj Qeveria vendos me shumice votash nga anetaret e Qeverise.
- (2) Ne rast kur seanca e Qeverise gjate votimit merr numer te nejte votash, vendimi i marre merret ai vendim ne te cilen ka votuar kryetari i Qeverise.
- (3) Votimi ne seancat e Qeverise eshte publik, pervec nese me Rregullore nuk eshte peracaktuar qe per raste te caktuara votimi te jete i fshehte.

Neni 21

- (1) Qeveria mund te vendos edhe me shumice votash te anetareve te Qeverise pjesmarres ne seance, kur merr masat urgjente per relaizimin efikas te sigurise se shtetit dhe per zbatimin e pergaditjes per mbrojtje dhe rrethana tjera te jashtezakonshme.
- (2) Anetari i Qeverise i cili per shkaqe te arsyeshme nuk merr pjese ne seance ne te cilen eshte vendos lidhur me rastet e paragrafit (1) te ketij neni, mund te kerkoj thirrje te seaces se re te Qeverise ne afat prej 24 oresh nga mbajtja e seances, ne te cilen do te shqyrtohet dhe do te vendoset per ato raste.

Neni 22

- (1) Me ftese te kryetarit te Qeverise, per shkat te pjesemarrjes shqyrtim dhe dhenien e mendimeve dhe propozimeve per te cilet jane thirr ne seancen e Qeverise, pa te drejte vendimarrje, mund te marrin pjese drejtoret te cilet udheheqin me organe tjera te drejtorive shteterore dhe organizmat drejtues, si dhe perfaqesues te ndermarrjeve publike, shoqatave te qytetareve dhe fondacioneve, institucioneve dhe personave tjere juridik.

(2) Ne rregulloren e Qeverise percaktohen edhe personat tjere te cilet mund te marrin pjese ne senacat e Qeverise.

Neni 23

(1) Per diskutimin e ceshtjeve qe kane te bejne me kompetencen e saj Qeveria mund te themeloje borde dhe komisione.

(2) Lloji, numri, perberja dhe fusheveprimi i trupave punues nga paragrafi 1 te ketij neni rregullohen me Rregulloren e punes.

Neni 24

(1) Qeveria themelon edhe keshilla profesional si trupa konsultativ te perhershem. (2) Keshillat e profesional nga paragrafi (1) i ketij neni, me kerkese te Qeverise ose me iniciative vetanake, shqyrtojne dhe japin menime profesionale per ceshtje te caktuara juridike, ekonmike dhe ceshtje te tjera.

(3) Kryetari dhe anetaret e keshilave professional i emron dhe shkarkon Qeveria ne menyre dhe procedure te percaktuar ne Rregullore.

VI. MARREDHENIET E QEVERISE ME KUVENDIN

Neni 25

(1) Qeveria i realizon marrdheniet e saj me Kuvendin ne kornizat e te drejtave dhe detyrimeve te percaktuara me Kushtetute dhe me ligj.

(2) Qeveria i jep mendim Kuvendit per ceshtje te cilat jane ne kompentence te saj. (3) Qeveria pas prpozimit per sjelljen e ligjit te propozuar nga propozues te tjere te autorizuar, dergon mendim deri te Kuvendi ne afat prej 15 ditesh nga dita e pranimi te propozimeve.

VII. MARREDHNIET E QEVERISE ME PRESIDENTIN E REPUBLIKES SE MAQEDONISE

Neni 26

(1) Qeveria i relaizon marredheniet me Presidentin e Republikes se Maqedonise ne kornizat e te drejtave dhe detyrimeve te percaktuara me Kushtetute dhe me ligj.

(2) Ne realizimin e te drejtave dhe detyrimeve Qeveria e informon Presidentin e Republikes se Maqedonise dhe mundet te kerkoje nga Presidenti I Republikes te informoje Qeverine per ceshtje te caktuar te cilat rrjedhin nga kompetencat e tyre ne kryerjen e pushtetit ekzekutiv.

VIII. MARREDHENIET E QEVERISE KUNDREJT ORGANEVE SHTETERORE DHE ME NJESITE E VETADMINISTRIMIT LOKAL DHE QYTETIT TE SHKUPIT

Neni 27

- (1) Qeveria percakton drejtimet dhe qendrimet per ekzekutimin e ligjeve dhe dispozitave tjera.
- (2) Me drejtimet dhe qendrimet percaktohet menyra e punes se ministrive, organeve tjera te administrates shtetore dhe organizacionet drejtuese ne ekzekutimin e ligjeve dhe dispozitave tjera, percaktohen afatet e sjelljes se akteve me te cilat keto organe jane te autorizuar dhe per raportimin e raporteve per ceshtje te ndryshme; percaktohet menura e bashkepunimit me organet tjera shtetore, si dhe ceshtje tjera te rendesishme per zbatimin e funksioneve te ketyre organeve.

Neni 28

Qeveria mund te jep udhezime ministrit te caktuar, perkatesisht drejtorit qe udheheq me organ tjetër te administrates shtetore dhe organizacionet drejtuese, si dhe te ekzekutoje udhezimet dhe qendrimet e Qeverise.

Neni 29

- (1) Qeveria, nese konsideron se ndonje akt qe e ka sjell ministri nuk eshte ne pajtim me Kushtetuten, ligj apo dispozite tjetër, mund per ate te paraqese ministrit.
- (2) Qeveria mund ta pengoje ekzekutimin e aktit te cilin e ka sjell ministri, nese konsideron se nuk eshte ne pajtim me Kushtetuten, ligjin dhe dispozite tjetër dhe propozon ministrin afat te cakuar qe ta ndryshoje ose terheqe aktin.

Neni 30

- (1) Qeveria kryen mbikqyrje mbi punen e ministrive dhe organeve tjera te administrates shtetore dhe organizacioneve drejtuese.
- (2) Qeveria ka te drejte dhe detyrim te shfuqizojë ose anulojë dispoziten ose akt tjetër te ministrive, organeve te administrates shtetore dhe organizacioneve drejtuese qe nuk jane ne pajtim me Kushtetuten, ligjin dhe dispozitave tera te Kuvendit, perkatesisht dispozitave te Qeverise.
- (3) Qeveria ka edhe te drejta dhe detyrime tjera ndaj organeve te administrates shtetore te percaktuara me ligj.

Neni 31

Ministrat jane te detyruar te njoftojne Qeverine per aktet t cilat I sjellin, te cilat kane te bejne me menyren e realizimit te te drejtave kushtetuese te qytetareve, udhezimet e Qeverise, disponimin me mjetet financiare (shpenzimet) dhe ceshtjet tjera me rendesi ne fusheveprimin e ministrise.

Neni 32

- (1) Organeve te njesive te vetadministrimit local dhe Qytetit te Shkupit, Qeveria mund te jep ndihme profesionale dhe ndihma tjera te rendesishme per realizimin dhe ekzekutimin e detyrave te tyre.

(2) CNdihma profesionale konsiston vecanerisht ne: dhenien e mendimit profesional dhe udhezimet per zbatimin e dispozitave, mendimin per ceshtjet organizative dhe ceshtjet tjera ne interest e funksionimit te drejt dhe avansimit te punes se organeve nga paragrafi (1) i ketij neni, si dhe ndihmeese tjeter profesionale ose ndihmesa te tjera.

Neni 33

Ne realizimin e bashkepunimit, organet e vetadministrimit local dhe Qytetit I Shkupit Qeverise I dergojne te dhena, informata dhe material tjera te rendesishme per realizimin e te drejtave dhe detyrimeve te Qeverise.

Neni 34

Qeveria ka te drejte te shfuqizojë dhe anulojë dispozita ose akt tjeter te organeve te vetadministrimit local dhe Qytetit te Shkupit nga kompetenca e besuar.

IX. AKTET E QEVERISE

Neni 35

Per ekzekutimin e ligjeve Qeveria sjell urdheresa me fuqi ligjore, urdheresa, vendime, udhezime, pregrame dhe konkluzione.

Neni 36

(1) Me urdheresa me fuqi ligjore Qeveria rregullon ceshtje nga kompetenca e Qeverise ne rast te gjendjes se luftes ose gjendjes se jashtezakonshme nese nuk ekziston munesia e thirrjes se Kuvendit..

(2) Me urdheresa Qeveria rregullon ekzekutimit e ligjeve; percakton parimet per organizimin e brendshem te ministrive dhe organeve tjera te administrates shteterore dhe percakton marredhenie tjera ne pajtim me Kushtetuten dhe ligjet. (3) Со одлука Владата одлучува за одделни прашања и мерки за извршување на законите; основа стручни и други служби за своите потреби и заеднички служби за потребите на Владата и на министерствата и другите органи на државната управа.

(4) Me udhezim Qeveria e shenon menyren e punes se ministrive dhe organeve tjera te administrates shteterore.

(5) Me program percaktohen ceshtjet te ndryshme nga kompetenca e Qeverise te cilat jane te nevojeshme per percaktimin e dinamikes dhe afateve. Programi permban plan financiar per realizimin e tij.

(6) Me vendim Qeveria kryen emrimin dhe caktimin, perkatesisht shkarkimin nga detyra e drejtoreve te cilet udheheqin me organin e administrates shteterore, skeretarin shteorer perkatesisht general dhe emerime dhe shkarkime tjera per te cilat eshte e autorizuar dhe vendos per ceshtje tjera dhe per ceshtje administrative.

(7) Me konkludim Qeveria merr qendrim per ceshtje qe ka diksutuar ne seance; percakton menime ne baze te propozimeve ligjore dhe dispozitave tjera dhe ne baze te materialeve te cilat deri te Kuvendi i kane

propozuar propozues te tjere te autorizuar; vendos per ceshtje te ndryshme te organizimit te brendshem dhe marredhnieve ne Qeveri; i percakton detyrat e ministrive dhe organeve tjera te administrates shteterore dhe detyrat e sherbimit te saj dhe merr qendrimet per ceshtje nga komentencat e saj.

X. SIGURIMI I EKZEKUTIMIT TE VENDIMEVE TE GJYKATES KUSHTETUESE TE REPUBLIKES SE MAQEDONISE

Neni 37

Qeveria siguron ekzekutimin e vendimeve te Gjykates Kushtetuese te Republikes se Maqedonise ne rast kur organet kompetente per ekzekutim te ketyre vendimeve nuk kane ekzekutuar vendimin e Gjyqit.

(Shfuqizohet me Vendim te Gjykates Kushtetuese te Republikes se Maqedonise publikuar ne "Gazeten zyrtare te Republikes se Maqedonise" nr. 26/01).

Neni 38

Ne varesi nga natyra e lendes se ekzekutimit, si dhe nga organi i cili ne kuptim te neni 37 nga ky ligj ka qene drejtperdrejte kompetent dhe i detyruar per ekzekutim te vendimit, ndersa me ligj tjeter ndryshe nuk eshte rregulluar, Qeveria sjell konkuze me te cilen me detajisht e percakton menyren e sigurimit te ekzekutimit.

(Shfuqizohet me Vendim te Gjykates Kushtetuese te Republikes se Maqedonise publikuar ne "Gazeten zyrtare te Republikes se Maqedonise" nr. 26/01).

XI. SEKRETARI GJENERAL I QEVERISE

Neni 39

(1) Qeveria ka sekretar general te cilin e emron dhe shkarkon Qeveria.

(2) Sa i perket Sekretariatit te Pergjithshem, Sekretari i Pergjithshem i ka te drejtat dhe detyrimet e funksionarit i cili drejton me organin e administrates shteterore, kurse puna e tij percaktohet me Rregullore.

(3) Per punen e vet dhe per punimet e Sekretariatit te Pergjithshem, Sekretari i Pergjithshem pergjigjet para Kryeministrit dhe para Qeverise.

(4) Sekretarit te Pergjithshem te Qeverise, Qeveria i emeron zevendes.

XI-a. SEKRETARI SHTETEROR

Neni 39-a

(1) Sekretari shteteror emerohet ne ministri, Sekretariatit per Ceshtje Evropiane dhe ne Sekretariatit per Implementimin e Marreveshjes Kornize.

(2) Sekretarin shtetëror e emeron Qeveria me propozimin e ministrit, perkatesisht funksionarit i cili udheheq me organin nga paragrafi (1) i ketij neni.

(3) Sekretari shtetëror e ka statusin e funksionarit.

(4) Sekretari shtetëror për punën e vet përgjigjet drejtperdrejt para Qeverisë dhe ministrit, perkatesisht funksionarit i cili udheheq me organin nga paragrafi (1) i ketij neni.

Neni 39-b

Mandati i sekretarit shtetëror perfundon me mandatin e Qeverisë.

Neni 39-v

(1) Sekretari shtetëror me punën e vet siguron punë efikase dhe efektive të organit, si dhe bashkimin e punës së organit; udheheq me shërbimin profesional të organit dhe u jep udhëzime nepunësve udheheqës dhe nepunësve tjerë, vecanerisht në kontekst të menaxhimit me resurset njerezore; përgjigjet për përparimin e organizimit dhe kushteve të punës së organit, rregullsine dhe azhurnimin e punës për lëndët dhe kryerjen e punëve në organ, si dhe zbatimin dhe realizimin e planit strategjik, programit të punës dhe buxhetit të organit; kujdeset për zbatimin në kohë të vendimeve dhe konkluzioneve të Qeverisë, si dhe drejtimet dhe udhëzimet e funksionarit i cili udheheq me organin; merr pjesë në punën e Kolegjiut të Përgjithshëm të Sekretareve Shtetërore; koordinon me përgatitjen e raporteve, propozimeve, programeve, informatave dhe materialeve tjera, si dhe materialeve për mbledhjet e Qeverisë, drejtperdrejt bashkëpunon me Sekretarin e Përgjithshëm të Qeverisë, me sekretaret dhe funksionarët tjerë të cilët udheheqin me organe tjera; mban kontakte në nivel perkates me organizata të vendit dhe ndërkombëtare, kur është i autorizuar për këtë merr pjesë në punën e trupave punuese të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe kryen edhe punë të tjera.

(2) Sekretari shtetëror i kryen edhe punët të cilat i kryejnë sekretaret lidhur me të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e nepunësve shtetërore në pajtim me Ligjin për nepunës shtetërore.

XII. SEKRETARIATI, SHËRBIMET PROFESIONALE DHE SHËRBIMET TJERA TË QEVERISË

Neni 40

(1) Për kryerjen e punëve të caktuara profesionale themelohet Sekretariat për ligjshëllim.

(2) Sekretariati për ligjshëllim i kryen punët që i perkasin sigurimit të konsistencës së sistemit juridik dhe dhenien e mendimeve profesionale për përputhjen e propozimit të ligjeve dhe të dispozitave tjera me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, me ligjshëllimin e Unionit evropian dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në përputhshëmeri me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë dhe jep mendime profesionale për dispozitat e komunave për të cilat Ministria për vetëqeverisje lokale atë do ta kërkojë.

Neni 40-a

(1) Themelohet Sekretariati i Pergjithshem si sherbim profesional i Qeverise.

(2) Sekretariati i Pergjithshem siguron bashkerenditje dhe perkrahje profesionale per nevojat e Qeverise, Kryeministrit, zevendesve te tij, si edhe per nevojat e anetareve te Qeverise ne realizimin e kompetencave te tyre; realizon bashkepunim dhe bashkerenditje me ministrite dhe me organet e tjera te administrates shteterore si edhe per ceshtjet me prioritet strategjik te Qeverise dhe ne vecanti per realizimin e Marreveshjes Kornize, bashkerendit propozimin, miratimin dhe percjelljen e realizimit te Programit vjetor per punimet e Qeverise; i siguron informatat e domosdoshme dhe keshillat e mendimet profesionale ne lidhje me krijimin dhe analizen e politikave te Qeverise; ne menyre operative e percjell dhe e njofton Qeverine per realizimin e konkluzioneve te Qeverise; siguron pergatitje efikase dhe mbajtjen e seancave te Qeverise dhe te trupave punues prane Qeverise, siguron informata per publikun; i bashkerendit aktivitetet qe kane te bejne me realizimin e reformes ne administraten publike, realizon bashkepunim profesional me Sherbimin profesional te Kuvendit te Republikes se Maqedonise, te Presidentit te Republikes se Maqedonise dhe me sherbimet profesionale te organeve te tjera te pushtetit shteteror, si edhe me organizata joqeveritare dhe me subjekte te tjera juridike; e realizon procesin e menaxhimit te punimeve, kryen edhe pune te tjera profesionale dhe logjistike te percaktuara me Rregullore, si edhe pune te tjera te cilat do t'i percaktoje kryeministri dhe Qeveria.

(3) Informimin e rregullt te opinionit publik per punen e Qeverise edhe per konkluzionet e miratuara, e kryen zedhenesi i Qeverise se Republikes se Maqedonise, te cilin e emeron dhe shkarkon Qeveria.

Neni 40-b

(1) Per kryerjen e puneve qe kane te bejne me ceshtjet evropiane dhe me sigurimin e bashkerenditjes te organeve te administrates shteterore dhe organeve e institucioneve te tjera, si edhe per kryerjen e puneve te tjera profesionale nga kjo fushe, themelohet Sekretariati per Ceshtje Evropiane.

(2) Sekretariati per Ceshtje Evropiane i kryen punet qe kane te bejne me: sigurimin e bashkerenditjes dhe harmonizimit te punes te organeve te administrates shteterore dhe organeve e institucioneve te tjera, per pergatitjen e Republikes se Maqedonise per aderim ne Unionin Evropian, perfshire edhe negociatat per aderimin tone ne Unionin Evropian; sigurimin e bashkerenditjes se aktiviteteve per realizimin e Marreveshjes per stabilizim-asocim te lidhur ndermjet Republikes se Maqedonise dhe Bashkesive Evropiane dhe shteteve te tyre anetare dhe marreveshjeve te tjera te lidhura ndermjet Republikes se Maqedonise dhe Unionit Evropian, si edhe te trupave punues te themeluara ne kuader te marreveshjes se lidhur dhe marreveshjeve te tjera me Unionin Evropian; sigurimin e bashkerenditjes te procesit te pergatitjes se versionit te Maqedonise "acquis communautaire" (E drejta e Unionit Evropian); sigurimin e bashkerenditjes per shkak te harmonizimit te punimeve te perfaqesuesve te Republikes se Maqedonise ne institucionet dhe trupat punues te Unionit Evropian; sigurimin e bashkerenditjes per shkak te harmonizimit te punimeve te Republikes se Maqedonise si shtet anetar i Unionit Evropian; sigurimin e bashkerenditjes se asistences nga jashte, nga ana e Unionit Evropian dhe shteteve anetare te saj dhe asistences tjeter nga jashte ne lidhje me reformat komplementare te procesit te integritimit te Republikes se Maqedonise ne Unionin Evropian; informimin e publikut me aktivitetet e nderlidhura ma procesin e integritimit evropian dhe ceshtjeve evropiane; si edhe me pune te tjera te nderlidhura me Unionin Evropian te cilat do t'i percaktoje Qeveria.

(3) Sekretariatin per Ceshtje Evropiane e drejton anetari i Qeverise i ngarkuar per ceshtje evropiane i cili i ka te drejtat dhe detyrimet e funksionarit i cili drejton me nje organ te administrates shteterore.

Neni 40-v eshte shlyer

Neni 40-g eshte shlyer

Neni 41

- (1) Per nevojat e veta Qeveria mund te themeloje edhe sherbime te tjera te pavarura apo sherbime te perbashketa profesionale dhe sherbime te tjera.
- (2) Me aktin per themelin te sherbimeve nga paragrafi (1) i ketij neni, percaktohet edhe organizimi i tyre dhe fusheveprimi i punes.

Neni 42

Dispozitat per te drejta, detyrimet dhe pergjegjesite e drejtoreve, zyrtareve udheheqes shteteror, dhe zyrtareve shteterore te tjere te percaktuar me ligj, zbatohen edhe te Sekretariati ligjvenes, Sekretariati i Pergjithshem, Sekretariati per Ceshtje Evropiane, dhe te sherbimet profesionale dhe sherbimet tjera te Qeverise, ne qofte se me kete ligj nuk eshte percaktuar ndryshe.

XIII. ZGJEDHJE PER QEVERI PER ZBATIMIN E ZGJEDHJEVE PER DEPUTETE

Neni 44

- (1) Per organizim te zgjedhjeve per deputete ne Kuvendin e Republikes se Maqedonise, Kuvendi i Republikes se Maqedonise me propozim te Kryetarit te Qeverise se Republikes se Maqedonise, njeqind dite para dites se mbajtjes se zgjedhjeve per deputete ne Kuvendin e Republikes se Maqedonise zgjedh minister te Puneve te Brendshme dhe minister te Punes dhe Politikes Sociale, me propozim te opozites me mandat i cili zgjat deri ne ditën e shpalljes se rezultateve perfundimtare nga Komisioni Shteteror i Zgjedhjeve per zgjedhjet e realizuara per deputete ne Kuvendin e Republikes se Maqedonise, me c'rast mandati u nderpritet sipas fuqise se ligjit.
- (2) Ministrin e Puneve te Brendshme e propozon partia ne opozite me numer me te madh te deputeteve ne Kuvendin e Republikes se Maqedonise, pas konsultimit paraprak me te dyja partite politike me numer me te madh te deputeteve ne Kuvendin e Republikes se Maqedonise.
- (3) Ministrin e Punes dhe Politikes Sociale e propozon partia ne opozite me numer me te madh te deputeteve ne Kuvendin e Republikes se Maqedonise.
- (4) Ministri i Puneve te Brendshme mund te kryeje me se shumti 15 shkarkime ose sistemime, ne vend me te ulet ose me te larte te bartesve te pozites udheheqese ne ministri, ne pajtim me ligjin. Ministri i Puneve te Brendshme mund te beje edhe sistemime horizontale te te punesuarve qe jane me propozim te tij ne numer deri 10% nga numri i sistemimeve horizontale te bazuara ne mesataren e ketyre sistemimeve ne vitin 2013 dhe 2014.

(5) Ministria e Financave dhe organet tjera te administrates shteterore dhe subjektet juridike, menjehere pas zgjedhjes se ministrit te Puneve te Brendshme nga paragrafi (1) i ketij neni, i miratojne procedurat per angazhimin e personave per nevojat e kabinetit te ministrit te Puneve te Brendshme.

(6) Me ditën e emerimit te personit ne pozite udheheqese nga paragrafi (4), ministri eshte i detyruar qe te emeroje zevendes plotesues me propozim te zevendesministrit plotesues. (7) Zevendesi plotesues i nepunesit udheheqes nga paragrafi (6) bashke dhe ne menyre te barabarte merr pjese ne realizimin e kompetencave qe dalin nga ligji dhe aktet

nenligjore.

(8) Te gjitha aktet ne kompetence te nepunesit udheheqes duhet te nenshkruhen edhe nga nepunesi udheheqes edhe nga zevendesi plotesues i nepunesit udheheqes. Nese akti eshte nenshkruar vetem nga njeri person konsiderohet se i njejti nuk prodhon veprim juridik.

Neni 45

Per organizimin e zgjedhjeve per deputete, Kuvendi i Republikes se Maqedonise me propozim te kryetarit te Qeverise se Republikes se Maqedonise, emeron zevendesminister plotesues (ne tekstin e metejshem: zevendesminister plotesues) ne:

- Ministrine e Puneve te Brendshme - te propozuar nga partia politike ne pushtet me numer me te madh te deputeteve ne Kuvendin e Republikes se Maqedonise;
- Ministrine e Punes dhe Politikes Sociale - te propozuar nga partia politike ne pushtet me numer me te madh te deputeteve ne Kuvendin e Republikes se Maqedonise,
- Ministrine e Financave - te propozuar nga partia politike ne opozite me numer me te madh te deputeteve ne Kuvendin e Republikes se Maqedonise,
- Ministrine e Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise se Ujerave, te propozuar nga partia politike ne opozite me numer me te madh te deputeteve ne Kuvendin e Republikes se Maqedonise dhe
- Ministrine e Shoqerise Informatike dhe Administrates - te propozuar nga partia politike ne opozite me numer me te madh te deputeteve ne Kuvendin e Republikes se Maqedonise.

Neni 46

(1) Mandati i zevendesministrit plotesues zgjat nga dita e zgjedhjes se tij deri ne ditën e shpalljes se rezultateve perfundimtare nga Komisioni Shteteror i Zgjedhjeve per zbatimin e zgjedhjeve per deputete ne Kuvendin e Republikes se Maqedonise, me c'rast mandati i pushon me fuqine e ligjit.

(2) Zevendesministri plotesues se bashku dhe ne menyre te barabarte me ministrin merr pjese ne realizimin e kompetencave te parapara ne Ligjin per organizimin dhe punen e organeve te administrates shteterore.

(3) Zevendesministri plotesues, se bashku dhe ne menyre te barabarte me ministrin i shqyrton dhe i nenshkrue te gjitha aktet dhe dokumentet qe i miraton ministri apo personi i autorizuar prej tij, zevendesministri si dhe sekretari shteteror ne ministrine perkatese, e qe u referohen ceshtjeve juridike, financiare dhe kadrovike lidhur me organizimin e zgjedhjeve.

(4) Cdo akt ne kuptim te ketij ligji dorezohet te ministri dhe zevendesministri plotesues. Ministri dhe zevendesministri plotesues kane per detyre menjehere, e me se voni ne afat prej nje dite ta miratojne apo refuzojne aktin ne kuptim te ketij ligji.

Neni 47

Nese akti apo dokumenti nga neni 46 paragrafet (3) dhe (4) te ketij ligji eshte miratuar, perkatesisht nenshkruar vetem nga njeri person konsiderohet se i njejti nuk prodhon veprim juridik.

Neni 48

(1) Ne rast te mospajtimit ndermjet ministrit dhe zevendesministrit plotesues ne ministrite, ne lidhje me ate nese ceshtja e caktuar juridike, financiare dhe kadrovike i referohet organizimit te zgjedhjeve, Komisioni Shteteror i Zgjedhjeve ka per detyre, ne afat prej 24 oresh te miratoje vendim dhe kete ta percjell te ministria perkatese.

(2) Vendimi i Komisionit Shteteror te Zgjedhjeve eshte perfundimtar.

(3) Ne rast te dyshimit te dale nga veprimi i mundshem joligjor nga ana e ministrit dhe/apo zevendesit te tij plotesues, mund te ngrihet padi ne gjykatën kompetente. Ne rast se kontestohen procedurat administrative dhe vendimet, per to mund te ngrihet padi ne Gjykatën Administrative kompetente.

Neni 49

(1) Me ditën e emerimit, zevendesministri plotesues ka te drejte te qasjes se pakufizuar ne te gjitha aktet, dokumentet dhe informatat te cilat jane ne dispozicion te ministrit.

(2) Te punesuarit ne ministrine me kerkese te zevendesministrit plotesues kane per detyre t'ia dorezojne te gjitha aktet, dokumentet dhe informatat te cilat jane ne dispozicion te ministrit.

Neni 50

Te drejtat e percaktuara ne Ligjin per rroga dhe kompensime tjera te personave te zgjedhur dhe te emeruar ne Republiken e Maqedonise" ("Gazeta Zyrtare e RSM-se numer 36/1990 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikes se Maqedonise" numer 38/1991, 23/1997, 37/2005, 84/2005, 121/2007, 161/2008, 92/2009, 42/10, 97/10, 162/10, 111/12, 145/12, 170/13 dhe 139/14), i takojne edhe zevendesministrit plotesues nga dita e emerimit, deri ne fund te muajit ne te cilin i ka pushuar funksioni.

Neni 51

(1) Zevendesministri plotesues ka te drejte per keshilltare te vecante dhe nepunes te kabinetit numri i te cileve eshte ekuivalent me numrin e keshilltareve te vecante dhe nepunesve te kabinetit ne kabinetin e ministrit, sipas Ligjit per nepunes administrative.

(2) Vendet e vecanta te punes nga paragrafi (1) i ketij neni mund te plotesohen me nepunesit administrative ne proceduren e rregulluar me Ligjin per nepunes administrative (mobilitet) apo ne proceduren pa shpalljen e konkursit publik.

(3) Punesimi ne vende te vecanta te punes nga paragrafi (2) i ketij neni zgjatderi ne skadimin e mandatit te zevendesministrit plotesues.

(4) Punesimi ne vende te vecanta te punes nga paragrafi (2) i ketij neni mund te pushoje edhe para skadimit te mandatit me kerkese te zevendesministrit plotesues apo me kerkese te te punesuarit.

(5) Gjate kohes se kryerjes se detyrave te punes ne kabinetin e zevendesministrit plotesues te punesuarit nga paragrafi (2) i ketij neni i pushojne te drejtat e marredhenies se punes nga vendi paraprak i punes.

(6) I punesuari nga paragrafi (2) i ketij neni ka te drejte te kthehet te punedhenesi paraprak ne vendin e njejte apo te ngjashem te punes qe i pergjigjet pergatitjes se tij profesionale me se voni ne afat prej pese ditesh nga dita e nderprerjes se shkakut per pezullimin e te drejtave nga marredhenia paraprake e punes.

(7) Rroga dhe kompensimet tjera te te punesuarve nga paragrafi (1) i ketij neni eshte perkatese me rrogen e keshilltareve te vecante dhe nepunesve te kabinetit ne kabinetin e ministrit.

XIII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PERFUNDIMTARE

Neni 43 eshte shlyer

Neni 44

Me ditën e hyrjes ne fuqi te ketij ligji shfuqizohet Ligji per Qeverine e Republikes se Maqedonise ("Gazeten zyrtare e RMS" numer 38/90 dhe "Gazeten zyrtare te Republikes se Maqedonise " numer 63/94 dhe 63/98).

Neni 45

Ky ligj hyne ne fuqi me ditën e publikimit ne "Gazeten zyrtare te Republikes se Maqedonise ".

DISPOZITA TE VLEFSHME KALIMTARE DHE PERFUNDIMTARE NGA NOVELAT E LIGJIT

I. "Gazeta zyrtare e Republikes se Maqedonise" nr.55/05

Neni 7

Punonjesit, pajisjen, inventarin, dokumentacionin dhe mjetet e punes te Sektorit per Integrim Evropian prane Sekretariatit te Pergjithshem, i ndermerr Sekretariati per Ceshtje Evropiane.

II. "Gazeta zyrtare e Republikes se Maqedonise" nr.115/07

Neni 4

Sekretariati per zbatimin e Marreveshjes kornize, aktet e reja per organizimin dhe sistematizimin e vendeve te punes, ne pajtim me ligjin, do t'i miratoje ne afat prej 30 ditesh prej dites se hyrjes ne fuqi te ketij ligji.

Te punesuarit ne Sektorin per zbatimin e Marreveshjes kornize ne Sekretariatin e pergjithshem vazhdojne me pune ne Sekretariatin per zbatimin e Marreveshjes kornize ne pajtim me Ligjin per nepunes shteterore.

Pajisjen, inventarin, dokumentacionin dhe mjetet e punes se Sektorit per zbatimin e Marreveshjes kornize, i ndermerr Sekretariati per zbatimin e Marreveshjes kornize.

III. "Gazeta zyrtare e Republikes se Maqedonise" nr.10/10

Neni 2

Sekretaret shteterore te emeruar para dites se fillimit te zbatimit te ketij ligji, vazhdojne ta kryejne funksionin si sekretare shteterore ne pajtim me kete ligj.

Neni 3

Sekretaret shteterore te emeruar nga radhet e nepunesve shteterore udheheqes, ne pajtim me Ligjin per nepunes shteterore ("Gazeta zyrtare e Republikes se Maqedonise" numer 59/2000, 112/2000, 34/2001, 103/2001, 43/2002, 98/2002, 17/2003, 40/2003, 85/2003, 17/2004, 69/2004, 81/2005, 61/2006, 36/2007, 161/2008, 6/2009 dhe 114/2009), para dites se fillimit te zbatimit te ketij ligji, pas skadimit te mandatit sistemohen ne vend pune me titullin qe e kane pasur para se te emerohen si sekretare shteterore.

Neni 4

Me fillimin e zbatimit te ketij ligji, shfuqizohen dispozitat nga nenet 6-a paragrafi 2 dhe 11 paragrafi 2 dhe ne nenin 36 paragrafi 2 fjalet: "I sekretari shtetedor" dhe numri "625" nga Ligji per nepunes shteterore ("Gazeta zyrtare e Republikes se Maqedonise" numer 59/2000, 112/2000, 34/2001, 103/2001, 43/2002, 98/2002, 17/2003, 40/2003, 85/2003, 17/2004, 69/2004, 81/2005, 61/2006, 36/2007, 161/2008, 6/2009 dhe 114/2009).

IV. "Gazeta zyrtare e Republikes se Maqedonise" nr.51/11

Neni 2

Procedurat e filluara dhe procedurat qe do te ngriten ne komisionet e Qeverise se Republikes se Maqedonise per vendimmarrje ne procedure administrative ne shkalle te dyte per ceshtje te vecanta

administrative deri ne ditën e hyrjes ne fuqi te ketij ligji, do te perfundohen ne pajtim me ligjet ne fuqi deri ne ditën e fillimit te zbatimit te ketij ligji.

Neni 3

Ligjet me te cilat percaktohet e drejta e ankeses ne komisionet e Qeverise se Republikes se Maqedonise per vendimmarrje ne procedure administrative ne shkalle te dyte per ceshtje te vecanta administrative, do te harmonizohen me dispozitat e ketij ligji deri ne ditën e fillimit te zbatimit te ketij ligji.

V. "Gazeta zyrtare e Republikes se Maqedonise" nr.142/16

Neni 3

(1) Pas nderprerjes se funksionit te ministrit te Puneve te Brendshme dhe ministrit per Pune dhe Politike Sociale ne pajtim me nenin 44 paragrafin (1) te ketij ligji, zevendesministri ne Ministrine e Puneve te Brendshme dhe zevendesministri ne Ministrine e Punes dhe Politikes Sociale, e marrin kompetencen perkatesisht e ushtrojne funksionin minister i Puneve te Brendshme, perkatesisht minister i Punes dhe Politikes Sociale ditën e ardhshme pas dites se shpalljes se rezultateve perfundimtare nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve per zgjedhjet e realizuara te parakohshme per deputete ne Kuvendin e Republikes se Maqedonise te cilat do te mbahen ne vitin 2016.

(2) Te gjitha vendimet eventuale te miratuara nga ministri i Puneve te Brendshme dhe ministri per Pune dhe Politike Sociale te zgjedhur ne pajtim me nenin 44, paragrafi (1) i ketij ligji, pas dites se shpalljes se rezultateve perfundimtare nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve per zgjedhjet e realizuara te parakohshme per deputete ne Kuvendin e Republikes se Maqedonise te cilat do te mbahen ne vitin 2016, jane te pavlefshme me fuqine e ligjit dhe nuk prodhojne veprim juridik.

VI. "Gazeta zyrtare e Republikes se Maqedonise" nr.140/18

Neni 3

(1) Pas pushimit te funksionit te ministrit te Puneve te Brendshme dhe ministrit te Punes dhe Politikes Sociale ne pajtim me nenin 44 paragrafi (1) i ketij ligji, zevendesministri ne Ministrine e Puneve te Brendshme dhe zevendesministri ne Ministrine e Punes dhe Politikes Sociale, e marrin kompetencen perkatesisht e ushtrojne funksionin e ministrit te Puneve te Brendshme perkatesisht ministrit te Punes dhe Politikes Sociale ne ditën e ardhshme pas dites se shpalljes se rezultateve perfundimtare nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve per zbatimin e zgjedhjeve per deputete ne Kuvendin e Republikes se Maqedonise.

(2) Te gjitha vendimet eventuale te miratuara nga ana e ministrit te Puneve te Brendshme dhe ministrit te Punes dhe Politikes Sociale te zgjedhur ne pajtim me nenin 44 paragrafi (1) te ketij ligji, pas dites se shpalljes se rezultateve perfundimtare nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve per zgjedhjet e mbajtura per deputete ne Kuvendin e Republikes se Maqedonise, jane te pavlefshme me fuqine e ligjit dhe nuk prodhojne veprim juridik.

